


FADIL
KRAJA

BIBLIOTEKA
SHËTETIT

814-7

K95



Fajin
e kishte
"Besa."



114-2
K 93

FADIL KRAJA

Fajin e kishte «Besa»

Tregime satiriko-humoristike



20276

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»


MIHAL DURI

Redaktore: **Irena Dono**

Piktor: **Shtjefën Palushi**

Tirazhi: 5000 kopje **Format: 70 x 100/32** **Stash. 2204-72**

Shtypur: Drejtoria Qendrore e Poligrafisë
Shtypshkronja «MIHAL DURI» — Tiranë, 1973



FAJIN E KISHTE «BESA»

Një ditë u ktheva nga puna i lodhur. U ngjita shkallëve të apartamentit ngadalë e me qejf. E dija se për darkë kishim peshk, krap të furrës, për të cilin unë le kokën. Derën e gjeta të mbyllur, por nuk më bëri përshtypje. Kushedi pse e kishte mbyllur gruaja. Trokita. Asnjë përgjegje. Trokita edhe një herë. Fqinji përballë, Ademi, hapi derën përgjysmë dhe më hodhi ndër këmbë çelësin. Unë hapa gojën ta pyesja si ishte puna, po ai më përplasi derën në turinj e u zhduk. Kujtova se e kishte me shaka «Do ta pyes mbas darkës», thashë dhe u futa në shtëpinë time. Ndeza dritën fill e në kuzhinë, Nuhata. Asnjë aromë peshku. Bile shporetit ishte akull. Fillova të bëhesha merak. Ku ishte gruaja?

Me këto mendime të zymta hyra në dhomën e fjetjes. Ndeza dritën dhe gjëja e parë që më ra në sy, ishte një dyfletëshe fletoreje e hapur dhe e mbështetur te radioja. Një shkrim i shpejtuar, ai i gruas sime, llogaritare, nxinte dyfletëshen. E mora ta lexoja dhe sa s'më ra pika:

Qenke krejt i ndryshëm nga ç'të pandeva. Shkatërrove dy familje! Mirë që nuk mendove për mua, po për fëmijët? S'kemi më punë bashkë. Lutjen për ndarje do ta paraqit nesër në gjyq.

Mira

P.S. Për plaçkat dhe banesën do të dërgoj vëllanë për t'i ndarë.

Kaq. Asgjë tjetër. E ku kishte nevojë për më tepër? Që të tallej gruaja ime, ishte e pamundur, mbasi ajo nuk i ka qejf shakatë. Por, edhe që të shkruante të tilla fjalë për mua, nuk durohej. Unë i poshtër?! Maskara?! Po këto fjalë i dëgjova edhe nga Ademi... «Ky diçka duhet të dijë, thashë. Do ta pyes. E, po qe se kanë vendosur të tallen me mua, do ta kenë keq!»

Me Ademin, që ta merrni vesh, punojmë në një ndërmarrje. I ka qejf shakatë, por ama kjo është shaka fare pa kripë.

Trokita te dera e Ademit. Ai e çeli dhe, kur më pa, deshi ta mbyllte, por unë u vura këmbën derës, dhe një të shtyrë, një të përplasur Ademin në dysheme.

— Me cilin talleni ju? Ku është Mira? Hajde, shpejt, ku e keni fshehur krapin? — e bombardova unë.

Ai nuk qeshi fare, por më shtrëngoi për gjoksi (dy pulla këmishë ndërkaq fluturuan) dhe më bërtiti:

— Të kujtoja burrë të ndershëm. Ti paske qenë një!.. Nejse! Por, që të arrish deri aty sa të kesh marrëdhënie me gruan time ti, që të konsideroja vëlla, këtë nuk ma merrte mendja! Nejse! Do ta bisedojmë në kolektiv. Tani shporru! Hajde shporru!

Tani isha unë ai që u bëra prush. Ia ktheva.

— Mos je i dehur? Unë marrëdhënie me gruan tënde! Me Besën?

— Ti, po! Ti, maskara! E di nga burime të sigurta.

— Fole me Besën?

— E nxora jashtë nga shtëpia. Tani ik, se e humba durimin...

Nuk di se si u gjenda në rrugë të madhe. Harrova lodhjen, krapin, dritat e apartamentit të ndezura dhe derën të çelur. Sa hap e mbyll sytë, u gjenda në shtëpinë e vjehrrit. Më doli përpara vëllai i gruas e më tha me një zë si bubullimë:

— Ti nuk ke më punë këtu!

— Dua të sqarohem me Mirën.

— Nesër e sqaroni në kolektiv.

(I vëllai i Mirës është mundës i kategorisë së parë.) U detyrova t'i bindesha.

Dita zbardhi. Mua më gjeti në ndërmarrje. Ata të turnit të tretë që kishin lënë punën, po lexonin një lajmërim.

«Sot në orën 15 bëhet mbledhje e turnit të parë për të shqyrtuar një akuzë të shokut Adem Kasapi kundër Selim...»

M'u morën mendtë. Për pak u rrëzova.

Tani e besoj fjalën që thotë se një orë nga njëherë të duket një muaj. E besoj, sepse unë e di se si erdhi ora 15.

Veç kolektivit ia marsha të keqen. Ai di t'i

qërojnë mirë lakrat. Të mos ishte kolektivi dhe zgjuarsia e shokut Tef, që e drejtoi mbledhjen, unë tani do të isha në pavionin e psikiatrisë.

Që thoni ju, thashethemet kishin formuar këtë tërkuzë: Një farë Paulini i kishte thënë Ademit, si njeri që «ia donte të mirën», se unë me të shoqen takoheshim përditë në stadium. Ademi besoi dhe vra-poi në stadium. Do ti që, duke dalë nga porta e stadiumit, pa të shoqen! Ajo i tha se ishte në punë vullnetare, por ai... (ju e dini se si veptoi).

Në mbledhje Zefi e detyroi Paulinin të kallëzonte se kush i kishte thënë dhe ja, tërkuzat nis e shtjellohet: Paulinit i kishte thënë Rustemi: «Selimi është i poshtër, ka marrëdhënie me gruan e Ademit». Rustemi, mbas shumë ngurimesh, e nxori se i kishte thënë Dhimitri: «Selimi do Besën. E di nga burime të sigurta. Veç të lutem mos e bëj muhabet...»

Pas tri orësh mbledhje doli kokrra. Dhimitrit i kishte thënë Demushi: «Selimi me Ademin janë rrahur për punë të Besës. Të lutem mos e hap». Shoku Zef pyeti Demushin se kush i kishte thënë: Demushi u përtyp u skuq, por më së fundi e nxori: — Sulltana...

Sulltana u ngrit e bërtiti:

— Po, unë po kaloja pranë klubit dhe i pashë Ademin e Selimin që po shamatoseshin...

— Ndal! — bërtita unë.

— Stop! — bërtiti Ademi.

Të gjithë na vështruan. Luajtën mendsh këta!?

Unë shpjegova:

Të hënën ne komentuam ndeshjen e skuadrës sonë me «Besën» e Kavajës. Ademi, tifoz i skuadrës sonë, ishte bërë spec që na kishte mundur «Besa» e

unë, për ta ngacmuar, lavdëroja «Besën». Ademi më pyeti me inat:

— Mor renegat, ti pse e lavdëron «Besën»?!

— Më pëlqen — i thashë.

(Në atë kohë pranë nesh kaloi Sulltana).

— Të pëlqen Besa?

— Po, e dua. E kam në zemër e nuk ka njeri që mund të ma nxjerrë.»

Sulltana u ndal pak, pastaj iku me vrap, thuri tërkuzën që shkoi aq gjatë, ajo pak, tjetri pak... Kusurin e dini.

Kthehemi në shtëpi me Ademin, Besën dhe Mirën. Jemi si në gjemba. Kemi turp të shikojmë njëri-tjetrin në sy.

Në apartament nuk kishte hyrë njeri i huaj, përveç maçokut të Besës që e kishte përllarë me kohë krapin. Të gjitha fajet i kishte «Besa».



TREGIM PËR SHOQEN ZYLFIJE

E kishin kritikuar në një mbledhje të komitetit të partisë se në ndërmarrjen e tij nuk punohej për emancipimin. Ai në fillim kundërshtoi, madje nxori dhe bllokun ku kishte mbajtur shënim sa mbledhje sektorësh e brigadash ishin bërë për këtë problem. U tha se kishte dhënë urdhër që gratë me barrë të mos i futnin në turnin e tretë dy muaj para lindjes dhe një muaj pas. Tregoi edhe masa të tjera që kishin marrë ai vetë personalisht, por sekretari e vuri me shpatulla për muri.

E pyeti se sa brigadiere, përgjegjëse turni, shefe reparti ishin femra në ndërmarrjen e tij, ku 65% e punëtorëve ishin femra?

Të nesërmen thirri në zyrë tre nëndrejtorët, shefin e kuadrit, sekretarin e partisë së ndërmarrjes dhe kryetarin e komitetit profesional. Bëri autokritikë para tyre dhe pastaj i pyeti se cilën grua mund

të bënin brigadiere sa për nisje. Ama të ishte grua, jo përralla. Grua që ta kishte zërin të trashë si burrë dhe, ose të mos kishte fëmijë, ose këta t'i kishte të rritur. Zylfija i kishte të gjitha konditat. U vendos një-zëri dhe pas një ore Zylfija ishte te drejtori. U zhvillua një bisedë e gjatë, e përzemërt. Qysh të nesërmen Zylfia filloi punën. Kolektivi i brigadës, ku shumica ishin femra, u gëzua shumë. Puna shkonte mrekulli. Nuk kaloi java dhe një shtetë tjetër për Zylfijen, e zgjodhën nënkryetaren e komitetit profesional. Nuk e lanë të hapte gojën fare. E meritonte, kish aftësi, etj. etj.

Kryetari e uroi dhe e caktoi të merrej me çështjen e edukimit. Të mos kishte frikë fare, puna ishte e lehtë, kryetari kishte besim dhe ... Kështu nisi punën. Tani, disa orë të kohës së lirë merrej me detyrën e re të komitetit profesional.

Por, si thonë pleqtë, kur të vjen e mira, hapi derën. Pas disa ditësh i thanë të dilte në fotografi, se do ta afishonin në këndin e kuq. Erdhi dhe një gazetar që e pyeti fare pak, ndërsa në gazetë shkroi shumë. Disa nga ato që lexoi në gazetë i erdhën krejt të reja, fundi, të tjerët dinë më mirë.

Që të mos e zgjatim, pas dy-tre muajsh, nga brigadiere e bënë shefe reparti, lagjja e zgjodhi në këshillin popullor dhe kryetare të kolektivit të agjitorëve. Këshilli i gruas së rrethit e zgjodhi në krysi, shkolla e zgjodhi kryetare të komitetit të prindërve...

Tani nuk kishte më kohë të lirë fare. Bam andej në mbledhje, bam këtu në mbledhje. Veç nuk u dha. I kreu të gjitha detyrat me aq sa i lejonin mundësitë dhe koha. I shoqi ia kuptoi hallet dhe i mori përsipër vetë punët e shtëpisë.

Mirëpo Zylfija nuk i doli drejtorit siç e priste. Filloi ta kritikonte nëpër mbledhje, madje, t'i kërkonte edhe llogari. Le të tjerat, por e turpëroi se gjoja i biri shkonte keq me mësim, paska sjellje të keqija në lagje e se drejtori nuk merrej me edukimin e tij.

Të themi të drejtën, drejtori u prek. Zylfija e kishte zërin më të trashë se sa duhej. Veç të tjerave kritikant e saj shqyrtoheshin në organizatën e partisë dhe aprovoheshin nga të gjithë. Drejtori u shkund dhe bëri autokritikë jo me fjalë, por me vepra. Në fillim me gjysmë zemre pastaj me zemër plot.

Po pikërisht kur drejtori e mbushi mendjen top se Zylfija ishte çapajeve dhe deshi ta propozonte për nëndrejtoreshë, ajo që shtatzanë dhe lindi një çun të bukur. Bashkë me çunin lindën edhe telashet e Zylfijes. Në mbledhje mungonte shpesh e më shpesh. Filluan ta kritikonin. Në fillim tërthorazi pa emër, pastaj direkt. «Shoqja Zylfije nuk. . .», etj. Dhe, kur kritikant u bënë kritike ata që i premtuan se do ta ndihmonin e ndimuan vërtet. Në fillim e thirri drejtori. U zhvillua një bisedë e shkurtër: me një hyrje të shkurtër: «Si e ke çunin, a të zgjon natën? . . .» dhe pastaj, larg e larg në temë: «Mos të pengon shumë përgjegjësia si shefe reparti? Mos ndoshta do të ishte mirë që të ktheheshe në brigadiere?»

Zylfija u bë brigadiere dhe më vonë, për ta ndihmuar dhe lehtësuar», e bënë punëtore. Shef reparti dhe brigadier u bënë dy shokë me «përvojë».

I dyti e thirri kryetari i komitetit profesional, i cili, për ta ndihmuar, i mori pëlqimin që në zgjedhjet e afërme të mos e propozonte në komitet. Nuk është më as kryetare e kolektivit të agjitorëve, as shkolla

nuk e zgjodhi në komitet të prindërve. Ka mbetur vetëm në këshillin popullor dhe në kryesinë e gruas. Detyrat që ka në këto organe i kryen për bukuri, madje e lavdërojnë.

Drejtori, që të mos e kritikonin përsëri se nuk e çmon gruan, po mendon të gjejë një tjetër Zylfije «me të gjitha konditat» që ta bëjë brigariere, shefe reparti, nëndrejtoreshë. Ka rënë në hall i shkreti! Ku ta gjejë një Zylfije, pastaj ku t'i degdisë shokët me përvojë?

JAM SHUMË I KËNAQUR

Nëndrejtori e mori fjalën i fundit. Hapi blokun e trashë të shënimeve, e shfletoi nga fillimi deri në fund, pastaj e mbylli dhe, pasi na shikoi të gjithë me radhë, nisi:

— Hëm... po, po... ta marrësh nga njëra anë, të duket se çdo gjë shkoi në rregull dhe unë nuk kam asnjë vërejtje për mendimin e komisionit. Fundi ky ishte provim i pjekurisë. Matematika është bazë e çdo shkence dhe nuk na lejohet të nxerrim kastravecë për shkollat e larta. Në përgjithësi, pra, bashkohem me mendimin tuaj. Veç po të më lejonit, do të bëja disa sqarime.

Të mos e lejonim? Llaf ishte ky? Ne i buzëqeshëm tërë ëmbëlsi dhe iu lutëm t'i parashtronte të gjitha sqarimet që kishte. Dhe ai, duke na falënderuar me gjithë zemër, tha:

— Për të gjitha sa do të them, të më besoni! Ju betohem për kokë të kalamajve, se nuk vë në dyshim aspak ndershmërinë tuaj, pjekurinë tuaj, sinqeritetin tuaj. Ja si është puna. Nga tridhjetë e një nxënës që kishte kjo maturë, ju mendoni të rrëzoni pesë në provimin e matematikës. Si përqindje kalimi është 81.25%. Ju më njihni mirë, unë dua të kalojnë ata që e meritojnë dhe nuk pyes fare për përqindjen, pa le të ketë shkolla rivale kalueshmërinë qind për

qind! Kështu kam qenë unë gjithnjë. Qeleperxhiu dhe dembeli nuk kanë vend në shkollën tonë. Pa le t'i shohim një nga një ata që keni vendosur t'i rrëzoni në provim.

— Një nga një i kemi pyetur, një nga një i kemi korigjuar provimet e tyre — tha mësuesi i lëndës.

— E kush tha të kundërtën? — qeshi nëndrejtori. — Ne kemi të bëjmë me njerinë, kapitalin më të çmuar... dhe çdo njeri është një komplikacion më vete, një tip, një sedër, një tru e një stomak më vete. Të fillojmë me Pranverën. Po kush është Pranvera? E bija e Muhametit, që vuan nga nervat, bile 10 vjet më parë ka qenë në pavionin 17. Po e mori vesh ai se i mbeti e bija, e vret. Pra, që të mos bëhemi nesër shkaktarë të një krimi dhe të na vrasë ndërgjegjja gjithë jetën, vëreni dorën në zemër dhe gishtin në kokë! T'i shpëtojmë jetën një vajze 18 vjeçare! Merrni shënim, ju lutem! — tha nëndrejtori, kur pa se ne po e dëgjonim me gojë hapur. — I dyti është Kujtimi. Ju të gjithë e dini se gjatë vitit ka qenë nxënës i mirë. Kërkoi të vazhdonte për agronomi. Tani është penduar dhe, meqë ka turp ta thotë hap-tazi, kërkon të na e hedhë, duke i gabuar me dashje problemet në provim. A duhet ta lemë të na bëjë sylleshë? Besoj se edhe ju jeni të mendimit se nuk e hamë atë kokërr ulliri. Ai të shkojë për agronom dhe të na dalë një kuadër i mirë për kooperativat bujqësore, që na japin bukën tonë të përditshme. Merrni shënim, ju lutem!

Ne morëm shënim «qëllimet e ulëta» të Kujtimit.

— Tani vjen e treta, Adriana. More shokë, po harruat se Adriana është kushërirë e shokut L. Dhe jo ndonjë e largët, por kushërirë e parë! Shoku L.

do të thotë se vepruam drejt, aq dinte, aq meritonte. Dakort. Po bota, opinionitë shoqëror ç'do të thotë? Ne kemi për detyrë të kujdesemi për emrin e një kuadri. Po pse, në këtë mënyrë kujdesemi ne? Merrni shënim, ju lutem!

I morëm shënim të gjitha dhe për Adrianën.

— Tani vjen Luljeta, recituesja dhe aktorja më e mirë e shkollës, more shokë! Luljeta, që na kënaqte shpirtin në mbrëmjet e vallëzimit, që kërcente aq bukur, që na bënte të gjithëve të qanim kur recitonte «Vajet» e Çajupit! E përse po e lemë? Sepse në dy problemet me shkrim që në fillim të një veprimi ka shkruar minus në vend të plusit, dhe, meqë kështu ka vazhduar deri në fund, ka nxjerrë përfundime të gabuara. Po të mos gabonte atë minus dhe të vinte plus, do t'i shkrinte fare problemet. Po ja që gaboi! Tani ne duam ta marrim në qafë. T'i prisim të ardhmen, ëndrrën e saj për t'u bërë aktore teatri! E për çfarë? Për një minus të shkretë, që në skenë nuk do t'i duhet fare. Luljeta do të bëhet e famshme dhe bota do të thotë, siç thanë për shpikësin Markon: «Ca pedagogë miopë e patën mbetur në maturë për një minus». Merrni shënim, ju lutem!

Morëm shënim, se për pak u bëmë personazhe komikë të së ardhmes për Luljetën tonë artiste.

— I pesti është Nevruzi. E lashë në fund, meqë është nip i im. Mua si nëndrejtor nuk më takon të flas, sepse jam edhe xhaxhai i tij. Po e meritoi të mbetet, mirë t'i bëhet qerratait! Vetëm dy gjera desha të thosha për të: Ka një javë që është me rrufë, madje në provim, po ta keni vënë re, kishte nundën e skuqur dhe tri shami xhepi. Pastaj para një

muaji i vdiq gjyshi. Sidoqoftë, mos shikoni fare se është im nip. Veproni si t'ju thotë ndërgjegjja.



Tani unë po dal që ju ta keni më të lehtë të merrni vendimet përfundimtare. Hajde punë të mbarë dhe ndërgjegje të lartë!

Nëndrejtori doli dhe u kthye pas gjysmë ore me buzëqeshje të ëmbël në fytyrë.

— Si vendosët, o shokë?

I përcollëm që të pestë... — foli mësuesi i lëndës me nervozizëm.

Atij i ndriti fytyra dhe na dha dorën:

— Ju lumtë, shokë, dhe ju falenderoj në emër të drejtorisë. Ju them sinqerisht se jam i kënaqur nga ky komision. Asnjëherë në jetën time të gjatë, si udhëheqës shkollë, nuk kam ndeshur një komision të tillë kaq homogjen, kaq të paanshëm, kaq të ndershëm! Jo pse doli klasa qind për qind. Unë nuk çaj kokën për përqindje, edhe pse nuk më vjen mirë të na e kalojë shkollë rivale, por sepse i kemi shoshitur mirë të gjithë dhe i kemi kaluar nxënësit me meritë. Në shkollën tonë edukojmë kuadro të ardhme dhe jo tranguj.

— Ashtu mendojmë dhe ne — shtova unë.

Tani po thërras sekretaren që të bëjë lajmërimin poshtë. Besoj që edhe ju jeni dakort, që, derisa të përpilohen listat, hëpërhë të vërë një lajmërim se në provimin e matematikës kaluan qind përqind. Një kopje po ia dërgoj seksionit të arësimit.

— Pse qind për qind? — pyeti i çuditur mësuesi i lëndës.

— Po sa? Mos 101 për qind siç pat bërë një mësues fshati? — qeshi nëndrejti i.

— 81.25 për qind — u përgjegj mësuesi. Ju nuk më latë të flisja ndaj u keqkuptuam. Ne vendosëm që të mos e ndryshojmë vendimin e parë. Që të pestë i përcollëm në vjeshtë në lëndën time. Sqarimet tuaja na u dukën qesharake. U bindëm se ju nuk e kishit seriozisht.

Nëndrejtorit i ndërroi fytyra dhe i ngriu buzëqeshja në buzë.



TË MBETET MIDIS NESH

Në vitin e parë të jetës sime si mësues e prisja me padurim atë pasdreke të së shtunës kur mblidheshim në ndonjë fshat për të dëgjuar mësim të hapur, që ne i thoshim «mësim shembëllor». Një herë në muaj organizohej, po unë do të dëshiroja të bëhej një herë në javë. Posa vinte dreka e së shtunës, as bukë nuk haja, po i hipja biçikletës e drejt e në destinacion. Shi, borë e fortunë të kishte, unë gjendesha në fshatin e caktuar, një orë para të tjerëve.

Sa herë që dëgjoja «mësimin shembullor», rrija me gojë hapët. Në kontrollin e dijes nxënësit ishin të shkëlqyer. Gjithë klasa me një shikim të mësuesit ngrinte gishtin në tavan, ndërsa ata që pyeteshin, në bankë apo në dërrasë të zezë, ishin të gjithë bilbila. Pastaj shpjegonte mësuesi. Sillej nga një mjet mësimor te tjetri. Disa madje i hapte papritmas. Unë



lëshoja një «aah». kënaqësie, ndërsa mësuesit e tjerë heshtnin. Kështu kaloi një vit. Dhe as që më shkante mendja se mund të vinte një ditë të jepja dhe unë një mësim të tillë. E quaja veten të padenjë. Mirëpo erdhi viti tjetër dhe kryetari i rrethit metodik aty nga gjysma e vitit më lajmëroi se në muajin e ardhshëm do të jepja mësim të hapur, prandaj t'i propozoja temën dhe, po të kisha nevojë, të shkoja për ndihmë në kabinetin metodik të qytetit.

Sa nuk më ra pika. Iu luta kryetarit të mos më caktonte, madje i thashë se isha i sëmurë dhe isha gati t'i paraqitja tri raporte mjekësore (kisha teton mjeke). Po ai ma preu shkurt, duke më dhënë zemër.

Një muaj torturë, një muaj hulumtime e studime të thella, net të tëra pa gjumë. Në kabinet shefi më rekomandoi të shpjegoja lidhëzat nënrenditëse.

— Do të më ndihmoni, ju lutem! — i thashë ose më mirë iu qava.

— Natyrisht, për këtë punë jemi — qe përgjegjja e tij ballsam.

Më tha të mbaja shënim. Dhe unë shkrova titujt e 36 artikujve që rrihnin këtë temë në revistën «Arësimi Popullor» dhe në gazetën «Mësuesi», nja 15 libra e broshura autorësh të huaj dhe të vendit. Të gjitha gjendeshin në kabinet, por duhej të studjoja aty. Sa vija nga fshati (më dhanë me këtë rast leje të vija çdo ditë), zhytesha në kabinet gjer në orët e vona kur më afrohej metodisti dezurn dhe më jepte të kuptoja se kishte kaluar orari. Në mbarim të muajit më ishin bërë trutë sallatë. Isha gati të jepja një leksion katërorësh në universitet për lidhësat nënrenditëse, por nuk isha në gjendje të jepja një shpjegim 20 minutash për këtë temë në mësimin e mallëkuar... Më falni, shembëllor.

Të enjtën, meqë kisha disa ditë e net pa gjumë, më ra të fikët në klasë. Kur erdha në vete, gjeta mbi kokë Shuaipin, një mësues të shkollës.

— Po ç'ke mor djalë? Tregoi Shuaipit si e ke hallin? Ke zënë dashuri me ndojë vajzë e ajo nuk të do?

Unë u zbraza një herë e mirë.

— Vërtet thua, apo je çmendur? — pyeti me sy të zgurdulluar, por, kur u bind se me rradaken isha në rregull, ia plasi një gazi me lot. Tani isha unë ai që dyshova se mos luajti. Pasi qeshi sa i dhembti barku, më vuri dorën në sup dhe mbajti ligjëratën si më poshtë vijon:

— Ti qenke për t'u qarë me lot. Një vandak me libra e artikuj ke lexuar? Mos u bëj merak, se të tregoj unë ty disa marifete, që të japësh jo një, po njëqind mësimë shembëllore.

Unë e shikoja i habitur, ndërsa ai vazhdoi:

— Hyrë që tani në klasë dhe shpjego mësimin që do të japësh pasnesër.

Unë desha të kundërshtoja, por ai ma preu:

— Dëgjo këtu e mos më ndërpre. Pasi të kesh shpjeguar lëndën, u thuaj nxënësve pa frikë se ky është mësimi që do të japësh të shtunën për gjithë mësuesit e zonës. Nxënësit janë mësuar me raste të tilla dhe nuk çuditën. Tani të kalojmë te kontrolli i dijes. Do të pyesësh dhjetë veta, dy ngriji në dërrasë të zezë e tetë nga vendi.

— Nxënësit më të mirë? — pyeta.

— Jo, në asnjë mënyrë. Të mirët ruaji për në fund, bile, po të duash mos i ngre fare. Mësuesit shikojnë regjistrin për të parë se cilët nxënës ngrite. Prandaj ti pyet ata më të dobëtit, që t'i lësh me gojë hapët kolegët e tu.


— Po ata nuk dinë asgjë — kundështova.

— Nuk dinë në orët e tjera, por të shtunën do të flasim si bilbilë, se do t'i përgatitësh ti. Jepua që sot pyetjet, ndërsa përgjegjet shkruajti qartë që t'i mësojnë përmendsh. Nesër bëj një provë që të mos gabosh dhe ngre njërin për tjetrin, se e merr tani punën pastaj... Kështu, pra, pyet dhjetë veta. Të gjithë vlerësoi me nota. Të jesh kurnac. Asnjërit mos i verë më tepër se tetë. Tani të vijmë te shpjegimi. Mos gaboj ta zgjatësh më shumë se 20 minuta. Bëj përfundimin. Ka 5 minuta kohë. Ngri nga vendi dhjetë nxënës të tjerë. Natyrisht edhe ata përgjegjen duhet ta mësojnë përmendsh. Ke pyetur në këtë mënyrë njëzet nxënës. Të mbeten dhjetë, ata që i ke më të mirët. Mos i pyet fare, i verë të rrinë andej nga fundi, ku do të rrinë kolegët. Ata do të kujtojnë se ata janë nxënës të dobët dhe mund t'u bëjnë ndonjë pyetje në bankë, kështu që do të binden përfundimisht se ti ke një klasë të mrekullueshme dhe se nuk mund të krahasohen dot me ty. Kaq, i dashur.

Këto ishin këshillat e Shuaipit. Në fillim kujtova se tallej, po, kur m'u betua për kokën e kalamajve se kështu veprojnë edhe ca të tjerë, u binda dhe vëprova ashtu siç më tha. Më doli një mësim i hatashëm. U ngritën e më shtrënguan dorën të gjithë. Madje një mësues nga entuziazmi më tha:

— Ti qenke me fat, o vëlla. Edhe nxënësit i paske të mrekullueshëm.

Mbi të gjithë mbeti i kënaqur drejtori, se iu ndërrua shkolla. Tani ai krenohet me mua, më quan mësues model dhe nuk lë rast pa u treguar inspektorëve mjetet që i kam dhuruar shkollës, të cilat sipas tij i paskam bërë të gjitha vetë me dorën time.



I GËZOFSH KËPUCËT E REJA!

Qeramudini i çuditi shokët e kolektivit, kur u tha se e kishte lënë duhanin. Ai pinte dy paqeta në ditë dhe gishtat i kishte gjithnjë si të zverdhura nga nikotina, ndërsa papritmas, drëng, e sikterisi të mallëkuarin, që «veç të këqija i sillte shëndetit».

Shokët në fillim u tallën me të, por, kur kaluan disa ditë e ai nuk futi në gojë asnjë cigare, pranuan njëzëri që Qeramudini ishte burrë, se kishte karakter të fortë. Madje, kur pas një jave ai u tha se ishte peshuar dhe kishte shtuar tre kilogram në peshë që nga dita e vendimit të madh, nja tri veta i dorëzuan paqetat, shkrepëset e çakmakët dhe i dhanë fjalën se do të ndiqnin shembullin e tij. Ndërsa Fuati që lozte rolin e sanitarit në repart, vendosi një fletërrufe përshëndetjeje për Qeramudinin dhe inisiativën e tij që po përqafohej dalëngadalë edhe prej të tjerëve. Natyrisht, Fuati e kishte tepruar një çikë, kur, duke

renditur të mirat që sjell lënia e cigares, kishte shkruar se pengonte dhe rënien e flokëve. Kjo nuk është e vërtetë. Fuati nuk pi duhan, por nuk ka asnjë qime në kokë. Nejse, fundi ai mund ta ketë lexuar në ndonjë broshurë edhe këtë të mirë. S'prish punë. E rëndësishme ishte se Qeramudini u bë i njohur në repart.

Mirëpo ai Gimi, mistreci, që fut hundët kudo dhe u nxjerr bishta namuslive të repartit, nuk besonte në vendimin e Qeramudinit.

— Unë nuk besoj se e ka lënë duhanin. Po të ishte kështu, gishtat duhet t'i ishin zbardhur. ndërsa ai vazhdon t'i ketë të skuqura.

Ky ishte një argument, prandaj filloi pëshpëritja. Mirëpo, pse të gënjente Qeramudini?

Dhe vërtet, pas disa ditësh akuza e Agimit u hodh poshtë, sepse Qeramudinit iu zbardhën gishtat.

— Tani t'u mbyll goja? — i thanë Gimit. Po ky për çudi u përgjegj:

— Prapë nuk besoj. Ai ka filluar ta pijë me pipë. Prandaj iu zbardhën gishtat.

Kjo nuk durohej. Ky Gimi, vërtet është i rinisë, por ama i ka qejf thashethemet. I duhet treguar vendi.

— Na e vërteto se e pi duhanin Qeramudini, përndryshe do të të vëmë fletërrufe.

— Qysh sonte jua provoj — tha Gimi.

Kaluan ca orë. Filloi të errej. Qeramudini, pasi shikoi si pa të keq orën e xhepit, u ngrit e doli jashtë repartit. Gimi u tha shokëve:

— Tani do ta njihni më mirë Qeramudinin. Dua dy dëshmitarë të vijmë pas meje.

Dolën dy. Fuati, si sanitar, dhe një nga ata që i kishte dorëzuar çakmakun dhe paqetën Qeramu-

dini. Gimi u priu dhe u futën në kabinat e zhveshjes. Kabinat ishin të ndara me mur të shkurtër, që nuk arrinte në tavan. Gimi u tregoi me gisht njërin kabinë. Dy dëshmitarët panë se nga ajo kabinë ngriheshin shtëllunga tymi duhani. Fuati hipi mbi kurrrizin e Gimit dhe vërejti brenda. Qeramudini thithte me ëndje cigaren nga një pipë e vogël druri.

Fuati deshi t'i fliste, por Gimi nuk e la. Shkuan në repart dhe pritën Qeramudinin. Njerëzit filluan të flisnin. Pse t'i gënjente kështu ai alamet burri? Njëri nga ata që kishte dhënë fjalën të ndiqte shembullin e tij, kërkoi aty për aty një cigare, por nuk ia dhanë. Edhe Gimi ishte nervoz, po për një arsye tjetër.

Gimi tha:

— Vërtet nuk e kuptoni pse e la Qeramudini duhanin kështu papritmas? Nuk ju shkon në mendje?

— Jo, ku ta dimë ne? Ka dashur të na shesë mend, s'ka tjetër?

— Po a nuk i keni rënë hiles se pikërisht në këtë orë ai largohet për pesë minuta nga reparti?

— Jo.

— Atëhere qenkeni naivë? Ka 20 ditë që jemi në muajin e ramazanit. Tani është kohë yftari. Qeramudini shkon të prishë agjërimin.

Kjo ra si bombë në kolektivin e vogël. U zemëruan aq fort me Qeramudinin, saqë disa nga padurimi deshën të shkonin e ta sillnin me vrap në repart e ta bënin për pesë para. Mirëpo ishte përsëri Gimi që i ndaloi.

Një natë më parë Qeramudini kishte blerë një palë këpucë të reja. Një ditë para bajramit erdhi në punë me këpucët e zeza, fringo të reja. Gimi iu afrua dhe e uroi:

— I gëzofsh këpucët e reja!
— Falemnderit! — u përgjegj Qeramudini.
— Qënkam të bukura! Ku i more?
— Në MAPO, dolën para ca ditësh.
— Vërtet? Si nuk i paskam parë? Unë kam kohë që kërkoj këpucë të tilla me lëkurë derri. sepse janë shumë të forta.

— Si the? Me lëkurë... — pyeti tjetri dhe u zverdh.

— E pra, me lëkurë derri. Nuk i shikon vrimat e qimeve. Janë shumë të forta. Një palë që kisha më shkuan disa vjet.

Qeramudinit i dolën djersë. I hoqi këpucët dhe u mori erë.

— Po deshe, merri të miat, se më vrasin të mallëkuarat — i tha Gimit, që e vështronte i qetë.

— Me gjithë qejf, po ç'numër janë? — pyeti Gimi.

— Numër 40.

— Aha, nuk kemi gjë. Unë e kam këmbën 44 — i tha Gimi dhe si pa gjë të keq u drejtua te vendi i punës.

Të tjerët që kishin dëgjuar me vëmendje bisedën, vunë re se «të mallëkuarat këpucë» e kishin vrarë aq fort Qeramudinin, sa nuk i veshi fare dhe punoi me çorape.

Në darkë një grup me në krye Gimin e priti në një qoshe të rrugës Qeramudinin. Pasi dolën të gjithë, ai hoqi këpucët dhe u nis zbathur për në shtëpi. Kur arriti qoshen e rrugës, Gimi, Fuati e të tjerë i dolën përpara papritmas dhe e bënë për ujë të ftohtë.

PSE KAKARISIN PULAT

Kryetari i kooperativës, Zenuni, thirri në zyrë Estrefin dhe iu përvesh:

— Ore Estref, pa më thuaj, pse të kemi vënë në pulari, të ruash pulat, apo sorrat?

— Pulat, shoku kryetar, nuk kemi akoma sorrari në kooperativë! — u përgjegj Estrefi dhe fshiu hundët me trinën e dorës së djathtë.

— Bukur fort, dhe mos na bëj estradë këtu, se e dimë që je i zoti.

— Sa pula more në dorëzim para gjashtë muajsh?

— Sa? Ku ta di unë sa?

— Se ruan sorrat, ndaj nuk e di. Ta them unë, 250.

— Meqë e thua ti, aq duhen të kenë qenë.

— Sa pula ke tani?

— Tani?.. Nja dyqind.

— Erdhi komisioni dhe i numëroi. Ishin 180.

— Unë i rashë në të gati.

— Po 70 pula ç'u bënë?

— Ama për ato pyet? Ca i zuri lia dhe i kthyen këmbët diellit, veterineri i pa; ca të tjera i hëngri dhelpra.

— Dhelpra? Ku i hëngri?

— Ku ta di unë? Se mos më lajmëroi...

— Ik, ore! Ato zakonisht bëjnë lajmthirrje pa-

ra se të sulmojnë. E ku ishe ti kur i hëngri dhelpra?

— Në pulari, ku tjetër?

— Çudi, si nuk të hëngri edhe ty?

— Duan mish të njomë ato, kryetar. Unë tani u plaka.

— Sa vezë dorëzoi plaku këtë javë në magazinë?

— Cili plak?

— Ti, de, kështu sikur the.

— Nja 300, në mos gabohem.

— Del pra se 180 pula gjatë një jave bëjnë vetëm një vezë e treçerek secila. Nuk të duken shumë pak? Me se e kalojnë kohën ato?

— Ç'ke me to, kryetar. Gjithë kohën kakarisin.

— Pikërisht këtu të kisha fjalën... A e di ti pse kakarisin pulat?

— Pse, kryetar?

— Sepse gëzohen që bëjnë vezët! Po ç'e do se vezët bëjnë bisht. Ku zhduken vezët, o Estref?

Estrefi ngriti supet.

Në nesërmen Estrefi erdhi në zyrën e kryetarit, duke mbajtur për bishti një mi të madh.

— E ruajta gjithë natën e më në fund e zura me vezë në dorë, shoku kryetar! — tha ai.

— Mos lojte nga fiqiri? — pyeti kryetari.

— Për kokë të Rustemit e kam me gjithë mend — u përgjegj Istrefi. — Kam parë shfaqje e shkuar shfaqjes. Që të bindesha se nuk isha në ëndërr, i lashë minjtë të futnin në vrimën e tyre 34 kokrra vezë. Pastaj u hodha mbi këtë mi, duke shpëtuar vezën e tridhjetepestë që po vidhte. Të tjerët u zhdukën nga frika. Desha të kapja të paktën atë që e tërhiqte, por më shpëtoi për një qime. S'bëhet gjë. Këtë e kapa, ama, dhe ta solla që t'i japësh dënimin!

Kryetari u ngrit në këmbë dhe i vuri dorën në ballë Estrefit.

— Mos je gjë i sëmurë, Estref? Po flet përçart.

— Jam shumë në rregull, shoku kryetar?

— Ke parë miun me vezë? Kujt ia hedh, ti?

— Askujt. Edhe unë gati lojta mendsh nga habia. Po deshe, eja sonte t'i shohësh vetë. Po, ama, duhet të rrish gjithë natën e të mos lëvizësh, siç ndënjë unë.

Kryetari nuk i besoi dhe shkoi të pyeste Bidon, kushëririn e parë të Estrefit. Ky pohoi se edhe gjyshi i tij paskësh parë dikur minj që vidhnin vezë. Atëherë kryetari dha alarmin. U blenë menjëherë 20 kurthe, të cilat u vendosën në çdo qoshe të pularisë. Asnjë efekt nuk pati. Asnjë mi nuk ra brenda, përkundrazi u sakatosën disa pula që kishin zgjatur qafën brenda kurthit për të ngrënë bukën e lyej me gjalpë, të varur në telin e çarkut.

Pastaj lëshuan plot mace. Ato u mbyllën në kotec, por pa rezultat. Macet iknin, posa çelej porta e kotecit. Pulat trembeshin.

Atëhere kryetari ua qau hallin disa kooperativistëve. Piloja, karrocieri plak i shtallave; tha:

— Mos u mërzit, kryetar, se e rregulloj unë këtë punë.

— Si do ta rregullosh? Do t'i zësh ti minjtë?

— Të gjithë jo, po një të madh do ta zë. Atë që ha edhe vezët, edhe pulat. Më lërë afat deri të hënën. Të hënën karrocieri u kthye fytyrëqeshur.

— E, mo, e zure miun e madh? — pyeti kryetari.

— Akoma jo, por do të hyjë në kurth që sot. Të lutem më thirrë këtu Estrefin, se dua t'i them ca llafe.

Estrefi erdhi pas gjysmë ore.

— Më thirre, kryetar? — pyeti.

— Të thirra unë — tha karrocieri. — Doja të të pyesja sa pula ke në shtëpinë tënde ti, Estref?

— Tri pula dhe një gjel. Ti e di, se ia ke vënë



syrin gjelit tim për zërin e bukur që ka — tha Estrefi duke qeshur.

— Bën vezë gjeli yt?

— Po ty të pjell mëzati? — u përgjegj flakë për flakë Estrefi.

— Mua jo, po ty duhet të të bëjë vezë gjeli.

— Nuk të kuptoj — tha Estrefi me zë të ulët.

Plaka jote shet çdo të diel nga 100-150 kokrra vezë dhe dy tri pula në tregun e qytetit. Dje e pashë vetë dhe fola me të.

— Nuk është e vërtetë! — u hodh Estrefi i zverdhur.

Karrociери u kthye nga kryetari:

— Ja ku është miu i madh. Deri këtu ta solla vetë. Po deshe gjurmoje punën dhe sille këtu plakën, po deshe hap kurthin dhe lëre të ikë. Si të duash vepro. Veç lëri rehat macet e fshatit...

E GJETA ATË QË NDEZ



— Banakier, të lutem më sill një shkrepëse — tha klienti, një mesoburrë që pinte kafe në një qoshte të banakut.

Në lokal nuk kishte njeri tjetër, vetëm ata të dy. Klienti nxori një cigare me filtër dhe provoi ta

ndizte. Kleçka e parë ishte pa fosfor, prandaj e hodhi në tavllën e duhanit. Nxori të dytën. Posa e shkrepë, fosfori u thërmua. Në pjesën e zezë të kutisë së shkrepësës u vizatua një njollë e kuqe. Edhe atë e hodhi në tavëll. Nxori të tretën. E shkrepë. U dëgjua një zhurmë therëse dhe një tym bojë hiri u ngrit mbi banak. Kokrra e fosforit u bë e kuqe flakë, por flakë nuk lëshoi. Fosfori si një fishekzar kinez i klasit të parë u shkëput nga kleçka, bëri një rrotullim dhe u ngul mbi bluzën e bardhë të banakierit duke i lënë si kujtim një vrimë të zezë.

— Më fal! — tha klienti i skuqur.

— S'ka gjë, vëlla, vazhdo punën ti — u përgjegj banakieri i njerëzishëm.

E pesta, e gjashta dhe e shtata nuk kishin fare fosfor ose kishin aq pak, sa që klienti, i sigurt se nuk do të ndizeshin, i hodhi në tavëll. E teta, si për kompesim kishte marrë fosforin e shoqeve të saj. Gjatë gjithë kleçkës ishte shtrirë masa e kuqërremtë e lëndës ndezëse. Klienti e shkrepri, por e pagoi rëndë, sepse kleçka u ndez si fitil dinamiti dhe i përcëllloi dorën. Për të shpëtuar dorën, e hodhi pa adresë, por kleçka gjeti pantallonat prej doku dhe la kujtimin e saj të përjetshëm.

Klienti vazhdonte të provonte njëherë pas tjetrës të gjitha shkrepëset dhe banakieri çuditej me gjakftohtësinë e tij. Në tavëll ishte formuar një kapicë me kleçka, ca të bardha, ca të thyera, ca pa fosfor, të tjerat me fosfor të djegur përbrenda. Ndërkaq cigarja vazhdonte të ishte e pandezur në gojë. Kishte mbetur një kleçkë.

Shkrepësja e fundit. Banakieri ishte në ankth. Klienti e shikoi banakierin si për të marrë zemër, mbushi mushkëritë me frymë dhe e shkrepri. Kokërrza, pasi lëshoi një zhurmë të keqe dhe tym që të digjte sytë, pasi bëri disa naze dhe zjarri e skuqi të tërën, bëri zemrën gur dhe lëshoi një flakë të dobët. Në fillim flaka kishte ngjyrë të gjelbër, pastaj nga masat mbrojtëse, që mori dora e klientit, u bë e kuqe. Banakieri qeshi i lehtësuar, si pas një pritjeje plot ankth kur sulmuesi e kthen më në fund në gol penalltinë e dhënë, ndërsa klienti gjakftohtë ndezi më së fundi cigaren dhe piu kafënë që kishte mbetur në filxhan dhe që ishte ftohur fare.

Kaloi kështu shtatë ore. Klienti duket se priste njeri. Porositi edhe një kafe tjetër. Banakieri ia poqi,

këtë radhë si për mik, gjithë shkumë dhe të trashë. Klienti u kënaq. Kjo kënaqësi i solli kënaqësinë tjetër. Nxori edhe një filtër dhe ishte gati të shihte një shfaqje tjetër. Klienti këtë radhë ndërroi taktikë. E çeli fare kutinë dhe gjithë shkrepëset i zbrazti në banak. I rreshtoi njëshkolonë, pastaj i numëroi. Nuk dolën 50, por 37 kleçka. Nejse, atij kjo nuk i interesonte. Pas shumë lëkundjesh zgjodhi më të mirën. E shkrepë. Fitore! Shkrepësja u ndez. Klienti ndezi cigaren i kënaqur. U kënaq dhe banakieri. Pastaj klienti për habinë e banakierit i mblodhi kleçkat e tjera dhe bashkë me kutinë e hodhi në koshin e plehrave që gjëndeje në qoshe të banakut. Në fillim banakieri kujtoi se klienti gaboi, por, kur ky i fundit nuk e prishi terezinë dhe vazhdoi të pinte kafënë i qetë, ndërhyri:

— Më fal se po të shqetësoj. Hodhe gabimisht kutinë e shkrepëses në koshin e mbeturinave.

— Jo, nuk e hodha gabimisht. Me dashje e hodha — u përgjegj tjetri.

— Pse, ajo ishte plot...

— Vërtet ishte plot, po ç'më duhet. Unë e gjeta atë që ndizte. Pata fat që e gjeta në fillim.

Banakieri tundi kokën i menduar. Pastaj shikoi vrimën e zezë në bluzën e tij të bardhë, kujtimin që i la klienti i çuditshëm.



NUK DO TA PËRSËRIS KURRË MË.

Një herë, ju betohem se vetëm një herë pata marrë guximin ta kritikojta dhe bile ajo as mund të quhej kritikë, por një shaka e vogël. Fajin e kanë ata të redaksisë së gazetës lokale që u bënë shkaktarë. Ja si ndodhi, more vëllezër. Dy javë para Vitit të ri, një shok i gazetës më takoi rastësisht në rrugë dhe m'u lut që me rastin e Vitit të ri të shkruaja ndonjë epigram satirik.

— Mos na lërë në baltë! Na ndihmo, se ty të vjen përdore humori — m'u lut shoku redaktor dhe unë, që nuk di t'ia prish njeriut, i premtova. E thirra një mbrëmje muzën, e ajo që herë të tjera vonohet qamet, këtë radhë erdhi aty për aty si të kishte qenë prapa derës. Erdhi e më ndihmoi të sajoja ca

epigrame të kripura. Them të kripura, sepse ata që ua adresoja këto epigrame u thartuan në fytyrë kur i lexuan.

Njërin nga këto epigrame unë ia drejtoja Komunales, së cilës, duke i uruar Vitin e ri, e këshilloja të mos na i vononte aq shumë drutë e zjarrit siç e kishte bërë zakon.

Epigramet u botuan natën e vitit të ri dhe unë edhe sot vuaj të zezat që shkaktoi ai numër gazete. Sepse, ato që pësova unë, mos i pësoftë njeri.

Të nesërmen e takova drejtorin e komunales që me buzëqeshje «më falenderoi sinqerisht për kritikën». I kishte pëlqyer shumë dhe ajo kritikë «do t'i ndihmonte për ndreqjen e të metave». Madje, meqë unë po shkoja për të prerë një kupon drush, më premtoi se do të ndërmjetësonte që, jo vetëm të m'i sillnin me kohë, por mundësisht dru lisi.

Unë i prita ato dru lisi një muaj. Kur rezervat në shtëpi u mbaruan dhe dimri ishte në kulmin e vet, mora guximin dhe me shumë ëmbëlsi i telefonova magazinës së druve. Doli një burrë. Më dëgjoi me vëmendje, mori shënim numrin e kuponit, pastaj kërkoi emrin dhe mbiemrin tim. Sa ia tregova, zëri i tij ndryshoi, u bë më i ashpër. «Prit radhën, shok», tha dhe sinjalet në receptor lajmëruan se ai kishte mbyllur telefonin.

Prita «radhën». Edhe dy javë të tjera. Mora dru borxh të fqinjit, bleva një gomar dru shkoze te një fshatar, dhe e kalova disi të ftohtët, Mirëpo drutë nuk po vinin. Gruaja e humbi durimin:

— Ti je i shastitur, — më tha — fqinjët tanë e kanë prerë kuponin para 10 ditësh dhe u erdhën drutë.

— Nuk është e vërtetë, nuk ka mundësi...
Mua drejtori më tha...

— Ç'drejtor, more, shko pyet fqinjët — u inatos edhe më shumë gruaja. Dhe unë, për ta bindur se nuk ishte ashtu, mora telefonin dhe, posa doli «ai burri» i magazinës së druve, e pyeta:

— Alo, magazina? Ju lutem më thoni drutë e cilës datë shpërndani sot?

— 30 janari — u përgjegj ai.

— Si, 30 janari? Unë i kam prerë më 3 janar dhe nuk më kanë ardhur ende — bërtita i inatosur, më tepër, sepse gruaja po qeshte me ironi.

— Nuk është e mundur, mos gënjeni! — foli ai i magazinës.

Kjo i vuri kapak bisedës, sepse magazinieri mbylli telefonin. Dhe unë u nisa për tek ai, megjithëse binte shi dhe magazina është në periferi të qytetit. Trokita, hyra brenda në atë barrakë të ngrohtë ku digjeshin dru lisi pa kursim. Pa folur i tregova përgjegjësit kuponin. Ai e mori, e vështroi dhe thirri:

— Ramadan!

Erdhi Ramadani dhe nxori një listë. Pas gjysmë ore e gjeti emrin tim dhe i qeshi fytyra:

— E gjeta — tha — Ja ku është. Drutë, dy racione, i ka marrë paguesi.

— Unë jam paguesi dhe nuk i kam marrë drutë

— qesha unë. Por Ramadani nuk qeshi fare, madje u bë nervoz.

— Ti mos u tall, shoku qytetar dhe mos na lërë pa punë. Drutë i ke marrë, sepse këtu në listë kemi shënimin «dërguar».

— More shoku Ramadan, derisa kam ardhur këtu...

— Unë flas me dokumenta, shok — ma preu ai. Unë u nxeha:

— Atëhere ç'do kuponi në dorën time, derisa drutë i paskam marrë?

Fola me dokument, prandaj e zura mat. Mua nuk më besoi, dokumentit po.

Belbëzuan, më lypën të falur për ndonjë gabim dhe më premtuan se pas dy orësh do t'i kisha drutë në shtëpi.

Pas 48 orësh shkova në drejtori.

Drejtori që më kishte premtuar dru lisi, «u skandalizua» për këtë gabim, madje bërtiti aq fort, sa që një dy vajza që po këndonin në zyrën përbri heshtën menjëherë.

— Drutë do t'i merrni, ndërsa fajtori që ju ka sorollatur do të dënohet, — Këto ishin fjalët, me të cilat më përcolli.

Prita dhe një javë, shkoi gjysma e shkurtit, por asgjë. Prapë u duka te drejtori, po këtë radhë ai më pa me inat:

— Pse i sorollatni karrocierët, shok? — më tha.
— A e dini se ata nuk jua kanë borxh këtë? Kanë ardhur dhjetë herë në shtëpi dhe nuk kanë gjetur asnjeri!

Kjo ishte ç'na ishte. Dola unë fajtor. I shpjego-
gova drejtorit se kjo ishte gënjeshtër me bisht
(natyrisht fjalën gënjeshtër e zevëndësova me fja-
lën «nuk është e vërtetë»), sepse në shtëpi rrinte
nëna plakë që vuante nga reumatizma.

Drejtori tundi kokën me mosbesim dhe përfun-
doi:

— Sot kam urdhëruar t'ju vijë përsëri karroca.
Po nuk gjeti njeri...

Drutë erdhën kësaj radhe. Dhe nuk ishin të këqia.
I kënaqur, bashkë me gruan, i vendosa stivë në
depo.



GJENIU I SHKOLLËS RREZIKOHET

Në dhomën e mësuesve u dha alarmi. Natyrisht nuk qe alarm ajror. Nuk ra sirena, u përplas vetëm regjistri i mësuese Sofisë në sipërfaqen e ndritshme të tryezës.

— Kjo nuk durohet!.. Kjo është e tmerrshme!
— bërtiste Sofia e skuqur në fytyrë.

Ne të tjerët që nuk po kuptonim se si e kishte hallin kolegja ,u trembëm pa masë dhe ku s'na shkoi mendja... Mua, për shembull më ngriu gjaku.

— Përsëri paskemi mbledhje sot pasdreke — thashë.

I kisha premtuar gruas të shkonim në kinema pas tre muajsh, sepse kjo ishte dita e vetme në këta tre muaj që drejtori na e kishte lënë të lirë. Tani po shtrydhja trutë si të aresyetohesha me gruan.

Selimit i shkoi mendja te ndonjë iniciativë e re e

shkollës që do të na i përllante nga orët e mësimimit një numër të mirë nxënësish për ditë të tëra... natyrisht me urdhër të drejtorisë. Ndërsa Besës i shkuan mornica në trup se mos ishte sëmurë përsëri mësuesja e biologjisë. Që të sqarohemi, në raste të tilla kjo mësuese nxirrte raport për një muaj dhe nxënësit kishin festë, sepse seksioni nuk gjente dot zevendës... ose sillte një mësues futbollist, i cili mblidhte rreth vetes tifozë dhe mësimin e merrte lumi pastaj.

Që të mos e zgjatim, ku nuk na shkoi mendja. Ja pse u grumbulluam rreth Sofisë, kush e kush ta pyeste më parë se si ishte puna. Dhe Sofia foli:

— Bardhyli... Bardhyli...

Pauzë.

Ngrirje gjaku nga ana jonë. Bile Besa kërkoi një gotë ujë, se po i binte të fikët. Mos i kishte ngjarë ndonjë aksident Bardhyli?... Kjo do të ishte katastrofë për shkollën tonë.

Humbje e pezëvendësueshme, sepse Bardhyli ishte zëvendësekretar i komitetit të rinisë së shkollës dhe anëtar i plenumit të rrethit, sekretar i rinisë dhe kujdestar i klasës III A, kryetar i komisionit të fletërrufëve të shkollës. anëtar i kryesisë së rrethit letrar, kryetar i dezurnit të bibliotekës, zëvendëskomandant kompanie në artileri, futbollist, qitës, aktor, recitues, këngëtar, balerin.. Jo, më falni, u ngatërrova, balerin nuk është, por ka në patronazh grupin e baletit. Pastaj si anëtar i lëvizjes «1 plus 2» ndihmon në mësimet dy shoqe të dobëta, pastaj... I harrova tani fare. Më falni që nuk i mbaj mend të gjitha detyrat që ka. Kështu i ndodh atij që nuk

mban shënime. Po edhe kaq, mjaftojnë besoj për t'ju bindur se ç'është për ne Bardhyli. Prandaj iu hodhëm Sofisë dhe e mbytëm me pyetje.

— Po folë të shkretën, ç'ka Bardhyli? E zuri maqina? Në spital është?

— Më keq akoma ka tri nota negative në fizikë-bëlbëzoi ajo dhe, për të na bindur, shfletoi regjistrin.

Selimi i zuri dorën dhe nuk e la. Të gjithëve një fllad i ëmbël dhe i ngrohtë na e shkriu gjakun. Bardhyli ishte shëndoshë, mbledhje nuk kishim pasdreke, ndonjë inisiativë nuk kishte lindur, as mësuesja e biologjisë nuk kishte sajuar ndonjë raport. Po atëhere pse qante Sofia? Për tri nota negative të fizikës? Ja paska vënë mësuesi i ri, Tasi, i cili zëvendesoi Jorgjin, që doli në pension. Punë e madhe. Bardhyli ka dy nënta e dy dhjeta me Jorgjin. Ai doli në pension vërtet, po notat e tij jo. Pra nuk ka rrezik se mbetet Bardhyli. Mund t'i dalë një tetë në fizikë si përfundimtare. Bukur fort. Kur të mbli-dhemi në këshillin pedagogjik, flasim. Drejtorja ia argumenton Tasit pse duhet t'ia nxjerrë dhjetë fizikën Bardhylit. Jo t'ia falë notën, të kuptohemi, por ta pyesë dhe një herë, të «bindet» edhe Tasi se Bardhyli është gjeni. Se, helbete, Tasi është i ri dhe nuk ka eksperiencën tonë. Ja, kështu do të rrjedhin punët.

Besa, pasi piu dhe një gotë me ujë, këtë radhë nga qejfi, iu shkreh Sofisë:

— Të lutem shumë, herë të tjera mos na tremb, ti e di se unë vuaj nga zemra.

Sofia për çudi u përgjegj ashpër:

— Bardhyli ka tri nota negative në fizikë dhe Tasi ka vendosur ta klasifikojë mbetës në këtë semestër.

— Po kush e lë ta mbetë? — fola unë. — Nuk turpërohet drejtori ynë para seksionit sidomos me klasën tënde që ka marrë iniciativë të kalojë 100% dhe me mesataren tetë.

— Megjithatë këtë semestër Bardhyli, si edhe gjashtë të tjerë, mbeten në lëndën time dhe nuk do të pranoj «t'i pyes edhe një herë.»

Ishte Tasi që i tha këto fjalë. Kishte hyrë në dhomë dhe po na buzëqeshte të gjithëve. Ne mbetëm me gojë hapur. Na doli e paparashikuar. Besa piu gotën e tretë me ujë, ndërsa Selimi tha:

— U pa puna. Edhe këtë pasdreke që e kishim të lirë do të na e zërë drejtori me mbledhje.

Dhe vërtet drejtori lajmëroi se pasdreke do të kishim një takim të shkurtër. U mblodhëm, drejtori në krye, ne përballë tij. Në një qoshe ndodheshin dy sekretarët e komitetit të rinisë së shkollës që zakonisht i ftojmë në këto «takime». Foli Sofia, si kujdestare e klasës III A. I dha ngjyra tragjike diskutimit të saj. Doli se Bardhyli me gjashtë të tjerët ishin martirë, ndërsa Tasi xhelat. Drejtori tundi kokën në shenjë se «deri diku ishte dakort me Sofinë.» Vetëm një herë e ndërpreu:

— Jo xhanëm, mos e merr ashtu. Ja, për këtë jemi mbledhur. Ta diskutojmë, të bëjmë autokritikë, të ndreqim gabimet që mund të bëjmë, se helbete njerëz jemi, edhe ngutemi.

Kur Sofia mbaroi, drejtori iu drejtua Tasit dhe e nxiti që të fliste.

Tasi qeshi. Po, kishte për të thënë diçka:

— Pikë së pari desha të sqaroja se nga 32 orë mësimi që kam bërë në klasë, 10 orë Bardhyli ka munguar me urdhër të drejtorit. Kam lajmëruar Sofinë disa herë se Bardhyli nuk di fare në fizikë dhe është qesharake të mendosh se ai gjoja ndihmon dy shoqe për të kaluar klasën. Çuditërisht gjithashtu se si Bardhyli qenka mirë në lëndët e tjera, sepse kam përshtypjen...

— Lëri përshtypjet për të tjerët. Folë për vete — ndërhyri drejtori.

— Edhe tek unë ka një notë negative — tha Ahmeti, mësuesi i algjebres.

— Besa dhe tek unë nuk është mirë. Dy herë nuk më është përgjegjur, por nuk i kam vënë notë, se kishte qënë në mbledhje — shtoi Besa.

U ngritën dhe nja dy të tjerë.

— Si është e mundur? Sofia nuk tha gjë për ju? — tha drejtori i çuditur.

— Vërtet, po të tjerët nuk më kishin deklaruar se do ta mbetnin në klasë dhe mendova se ju do të bisedonit me ta, si zakonisht... dhe pastaj Bardhyli «do të pyetej dhe një herë» — u përgjegj Sofia.

Drejtori i ra tryezës me grusht dhe mori fjalën. Foli plot një orë. Kritikoi Bardhylin që paska «shkarë», i bëri thirrje shpirtit të tij revolucionar, pastaj shpirtit tonë humanitar dhe si përfundim, na ftoi të gjithë «t'i pyesnim» edhe një herë ata

që kishin nota negative sepse shkolla jonë me tradita nuk mund të binte kaq poshtë. Me një fjalë avazi i vjetër.

Ne u bindëm. E pyetëm Bardhylin dhe nuk i prisëm traditat e shkollës, vetëm Tasi nuk u tund. Katër nota negative i nguli në klasën e Sofisë në fizikë. Kish një kokë Tasi që...

Si përfundim, Bardhyli me shokë tani nuk mungojnë fare në orën e fizikës për asnjë mbledhje dhe po e mësojnë lëndën e Tasit që ç'ke me të. Po edhe lëndëve tona u japin rëndësinë e duhur.

«TË FAMSHMIT» E LAGJES SONË

«ARTISTJA»



Përpara vitrinës së dyqanit të mishit qëndronte një djalë, të cilin në fillim e mora për të huaj; por, kur pashë se po lexonte revistën «Hosteni» dhe herë pas here lëshonte nga goja fjalën «budallëqe», u sigurova se ishte shqiptar. Djali kishte syze të reja, të kthyer anash, si ato që mbajnë moto-

çiklistët, një bluzë leshi ngjyrë rozë një palë pantallona që i binin të ngushta ndër vithe, ndërsa poshtë zgjeroheshin dhe pastaj çaheshin për t'u mbyllur me tirantë. Dy xhepat prapa dhe anash ishin të mbyllura me zinxhirë. Madje çdo zinxhir përfundonte me

një tufë të kuqe. Pantallonat kishin ngjyrë të gjelbër të hapur. Në këmbë kishte sandale plazhi me dy rripa të hollë për sipër. Kishte një sahat të madh dore, në kapësen e të cilit tundej një zinxhir i vogël dhe në fund të zinxhirit një prerëse thonjsh në formë kitare.

— Më falni, shok, desha t'ju pyesja...

Ai ngriti kokën nga revista dhe më vështroi përmes syzeve të errëta.

— Urdhëroni!

Zëri m'u duk i hollë, por... sa djem kanë zë të tillë.

— Doli «Hosteni» i ri? Apo është numër i vjetër?

— Jo, i riu është. Sapo e bleva.

— Mund ta shoh një minutë?

— Mundeni.

Ai më zgjati revistën, unë u zmbrapsa. Nuk ishte shok, por shoqe, vajzë jo djalë. E çfarë vajze! Revista më kishte penguar ta dalloja dhe unë belbëzoja:

— Më falni, ndoshta u fyeva... M'u dukët si djalë...

— Jam mësuar me fanatikët. Nuk fyhem nga ata — ishte përgjegjja rrufe.

Kjo m'u duk e rëndë, po hajde, thashë, duhet kapërdirë derisa e fyeva.

— Megjithatë, kështu si jeni veshur ju, çdo nje-

ri ju merr për djalë, pra nuk hyn fanatizmi këtu. Madje unë në fillim kujtova se mos jeni e huaj, ndonjë turistë... Me ato pantallona, me gjithë ata zinxhirë...

— Më falni, shoku Estref, por jeni injorant derisa nuk e kuptoni modën Kauboj, që përdoret sot në gjithë botën — më tha.

Pra edhe më njihte. E shikova me vërejtje. Ajo hoqi syzet dhe unë thirra:

— Ti qenke, moj Nife?

— Dora vetë.

— Po si kështu? Bën pjesë në ndonjë film, apo...

— Asgjë e tillë. Një veshje e thjeshtë... pa asnjë teprim — u përgjegj.

Pra na ishte Nifja e Zyberit, karrocierit të ndërmarrjes sonë. Kishte qethur flokët dhe na kishte sajuar një veshje të tillë. I ati është burrë i mirë dhe punonjës i dalluar, ndërsa e bija sillet bulevardëve dhe dyqaneve të veshmbathjes.

— Po në punë pse nuk hyn, moj Nife?

Ajo më shikoi si një antikë.

— Kjo nuk ju intereson.

— Hëm! — mërmërita dhe më pushtoi një ndjenjë zemërimi ndaj kësaj vajze që s'e kishte kuptuar si duhet jetën. Ndërsa ajo më përshëndeti me dorë.

«KËNGËTARI»



U dëgjua një britmë e çjerrë, një përplasje te neqeje nëpër gurët e kalldrëmit dhe një këngë me gjithë mushkëritë. Unë dhe gruaja u zgjuam si me komandë:

Unë fërkova sytë, sepse sapo më kishte marrë gjumi, ndërsa gruaja foli:

— Thanasi... përsëri i dehur... Ora dy pas mesit të natës... E mjera grua! Të gjerët kalamaj! Prite kur t'i rrahë.

Gruaja ndezi dritën e dhomës. Thanasi ishte ndalur mu nën dritaren tonë dhe ia thoshte me zërin e tij të mallëngjyer:

Kish ta kisha një djalo si Meeema,
paç me i hy ... kalasë për mreena...

Unë dola në dritare dhe i thirra:

— Ore Thanasziu... lëre, ore, kalanë. Futu në shtëpi më mirë, se zgjove gjithë lagjen:

Thanasi në fillim heshti. U mbajt pas shtyllës së telefonit dhe u mundua të ngrinte kokën. Por nuk arriti, se toka i sillej rrotull. E çliroj nga ai mundim duke i thënë:

— Zeneli jam, Zeneli.

Ai poshtë belbëriste me kadenca:

— Ti... ti... Zenel je... Ulu poshtë të han-gsha... syrin...

Unë i thashë me të butë.

— Shko në shtëpi tani!

Ai briti egër:

-Atë e di unë . . . unë . . . unë . . .

«Unë» u përsërit disa herë si pllaka e grama-fonit kur i ngel gjilpëra... Pastaj ndërroi recep-torin:

— Povero Rigoletto —

La la... la la... la la... la la,, la,, la,,


Gruaja ime donte ta përshëndeste me një legen me ujë, po unë nuk e lejova. Jam kryetar i këshillit të frontit të lagjes dhe nuk lejoj të fyhet personali-teti i qytetarit të lagjes sime. Zbrita poshtë që ta kapja për krahësh. Ai m'u bind dhe eci krah meje duke më puthur vazhdimisht në faqe ose më mirë duke lëshuar në fytyrën time jargë rakië dhe duh-më duhani.

E shoqja e Thanasit na priti te porta, ndërsa nga dritaret e apartamenteve u lëshuan në drejtimin tonë përshëndetje që nuk i lejon etiketa t'i për-mendësh.

— Këshilloje me durim, me të butë — i thashë.

— Po kjo është detyra ime, ndërsa ju në lagje, në punë bëni sa më shumë shir! — tha ajo dhe mbylli derën. Nga brenda buçiti kënga:

Mos u pift'o rakia... e shkretë...



— Shiko, bre Zenel, shiko të keqen se çfarë talenti ka! Për nder të familjes duhet lajmëruar Instituti i arteve që të mos shkojë dëm ky zeni.

Jovani, që zakonisht flet me romuze, këtë radhë e kishte seriozisht. Po më fliste për djalin e Femiut, Aristotelin, që na paska talent të mrekullueshëm për pikturë. Dhe vazhdoi:

— Pallati ynë është pesëkatsh. Po pse ta quajmë shtëpi banimi e jo ekspozitë personale të Aristotelit? Madje ekspozitë me tematikë, sepse çdo

kat ka një temë të posaçme të trajtuar në disa subjekte. Le të marrim katin përdhes. Shiko muret e korridoreve. Këto fytyra njerëzish, krahë, zogj, barka, peshq dhe balona janë etyde. Janë të punuara me zhdërvjelltësi të çuditshme. Ka përdorur tempera, gëlqere, qymyr, bojëra vaji, lëng shege... të gjitha ato që përdorin piktorët, shkollarët dhe bojaxhinjtë. Pa shiko se sa bukur i jep linjat e syve, po hijet dhe dritëhijet. Tani të kalojmë në katin e parë. Mund ta quajmë sektori i peizazheve. Shiko këtë këtu. Është plazhi i Durrësit. Ajo atje është anija «Vlora», madje e ka të shkruar në qiç, kurse këta janë shokët e Aristotelit të shtrirë në rërë. Aristoteli ka shumë shokë, por disa notojnë në det, i shikon atje larg? Te kjo tablo piktori ka dashur të përjetësojë shokët e vet, prandaj u ka vënë emrat në bark. Unë çuditëse pse janë zemëruar prindërit e shokëve të piktorit. Po ne jse, kaq kuptojnë nga arti ata. Ngjitemi në katin tjetër që mund të quhet «sektori i portreteve». Gjithë banorët e pallatit janë të pikturuar këtu. Piktori është surrealist, prandaj portretet mund të mos ngjasojnë fort me origjinalin, por ama janë të shikuar në perspektivë. Hatija, përshebull nuk përdor shkop, por do ta përdorë pas disa vitesh, dhe piktori pikërisht për atë periudhë flet.

T'ju them të drejtën, u binda për talentin e Telit (në shkurtim). Vizitova ekspozitën e tij personale dhe mbeta i kënaqur. Në çdo kat pashë kryevepra. Ajo që më çuditi ishte vullneti i piktorit dhe shfrytëzimi maksimal i mundësive për të çuar përpara talentin. Asnjë qoshe muri nuk kishte mbetur e bardhë.

— E, u binde? A nuk është një Rembrand i

vërtetë? — më tha i kënaqur Jovani dhe shtoi: —
Është nder për ne që e kemi në pallat.

Pohova me kokë. Madje kërkova të njihesha me
zheniun.

— Kollaj fort — tha Jovani. — Ulemi poshtë,
se atje po vizaton macen time që hipi në ballkonin
e Aristotelit dhe i hëngri dy zogj pule që u ka çelur
kloçka.

— Kloçka?

— Ede... shqip fola.

— Ku i ka çelur?

— Në ballkon. Pse çuditësh? Ka që mbajnë
edhe qengjin, pa le gjelat e detit që vërshojnë në
nëntor e dhjetor në çdo ballkon. Ku ta kisha llafin...
Aristoteli po vizaton macen në murin e jashtëm.
Tani ka filluar të vizatojë atje, sepse korridorët nuk
kanë më vend. Është një lloj fletërrufeje për macen
time. Ajo duhet të përgjegjet për krimin që ka bërë.

Zbritëm në oborr. Vërtet Aristoteli po vizatonte
dhe, ngaqë ishte përqëndruar në krijim, as që na
vuri re. Për teto Anastasinë e pa që po ecte e kërru-
sur me një kovë plehrash dhe i foli pa shkëputur
sytë nga piktura.

— Ku po shkon, teto?

— Ja, të keqen, të hedh plehrat në fuçi.

— Dhe je ulur nga kati i katërt me ato plehra?

— Si t'ia bëj, derisa ju, pionierët, nuk na ndih-
moni?

— Po hidhi nga dritarja, teto. Edhe mamaja
ime i hedh.

Unë iu drejtova Jovanit.

— Ti the se duhet lajmëruar Instituti i arteve?
Jovani u mundua të buzëqeshte.

— Po derisa ne lejojmë një «talent» të tillë të «shkrihet në punë» dhe nuk ua mbledhin prindërve të tij...

MIKROKONKLUZION

«Artistja», «Këngëtari» dhe «Piktori» u bënë dje personazhet kryesore të mbledhjes në këshillin e frontit.

I bëme për ujë të ftohtë.

ATË DITË QË U NISA NË PLAZH

Kunata, motra e gruas, është e martuar në Durrës dhe, për fatin e mirë tonin dhe të keq të saj, i kanë dhënë për banim dy dhoma e një kuzhinë në një godinë pranë plazhit. Me dy valixhe rrobash nga më të nevojshmet, duke përfshirë këtu radion transistor dhe dy palë letra bixhozi, një ditë vere isha te agjencia e autobusave gjysmë ore para nisjes. E kam zakon të jem përpara te agjencia, sepse të ngjasin të papritura. Shoferi i autobusit është njeri i pavarur. Ai mund ta nisë autobusin edhe një orë pas orarit dhe ti nuk ke të drejtë të ankohesh. Po ngjet që e nis pesë minuta para orarit dhe ti mbetesh me bileta në dorë. Mund të ankohesh, po nuk ka dëshmitarë, pastaj nuk fiton asgjë, se autobusi nuk kthehet pas...

Autobusi, për fat, ishte aty, dhe unë, pasi nxora një cigare me filtër dhe ia dhurova me buzëqeshje shoferit, iu luta të më hapte bagazhin që të futja valixhet brenda. Shoferi, pasi më bëri ta përsëritja disa herë kërkesën, më së fundi më tregoi se bagazhi ishte i hapur dhe unë e falënderova njëmijë herë që begenisi të më përgjegjej.

Nëna, gruaja, fëmijët u futën në maqinë dhe zunë vendet, ndërsa unë pija gjithë kënaqësi cigaren përjashta. Pasagjerët e tjerë posa kishin filluar të dukeshin, kur...

— Latif, po nisesh? — më thirri dikush nga pas. Ktheva kokën dhe pashë Skënderin, kolegun tim të punës. Në dorë mbante një kuti të madhe.

— Po nisem — i thashë. — Po ti, Skënder, për ku kështu? Ti sikur do të shkoje në Shëngjin?

— Për atje jam nisur, po kam motrën në Durrës. Më ka telefonuar t'i ble një tenxhere me presion, se nuk paska atje. Ja, e bleva, tani po kërkoj një njeri, që t'ia dërgojë. Do të ta jepja ty, po ti do të ndalesh në Shkozë.

— Mjerisht aty do të ndalem, se me gjithë qejf... — u përgjegja. Po gruaja nga brenda autobusit thirri:

— Merre ore, pse ia lë në dorë? Jeni shokë apo jo?

— Po do të ndalemi në Shkozë, moj grua!

— Mos u ndal ti. Ndalemi ne. Ti nisur në Durrës, kryej porosinë e shokut. Ja ku është Durrësi nga Shkozëti. Kthehesh për dy orë, me autobus urban.

E mora gjithë buzëqeshje duke iu përgjegjur falënderimit të tij: — S'ka përse, është gjë kaq e vogël...

Ai më dha adresën:

— Do të shkosh te pasticeria pranë Komitetit të Partisë. Do të futesh brenda dhe do të kërkosht Llambin.

— Burri i motrës është Llambi?

— Jo, një shok i tij. Do ta pyesësh dhe ai do ta tregojë adresën e shtëpisë.

— Ma trego ti adresën, pse të shkoj në pasticeri.

— Po nuk e di të shkretën, se kanë marrë apartament të ri. Llambi duhet ta dijë.

— Po nuk e gjeta Llambin?

— Atëhere nuk ke ç'bën, nisu te shkolla «Naim Frashëri», ndërtesa e tretë në krah të djathtë, ajo që ka një portë hekuri, ka qenë banesa e vjetër e motrës. Hyrë aty dhe pyet për banesën e re. Nuk ke ç'bën . . . siç e the dhe vetë, gjë e vogël është . . . sot ti për mua, nesër unë për ty.

Na dha dorën të gjithëve, fëmijët i përqafoi dhe u nis, duke më lënë në dorë tenxheren me presion, të cilën ia vura në prehër gruas. Ndeza një cigare dhe po vështroja diku nga dritarja, kur përballë qëndroi Koleci me një alamet shporte me vezë.

— Latif, ta marrsha, më thanë se po shkon në Durrës. Atje kam vëllanë, kabina Nr. 432. Më ka kërkuar vezë të freskëta. Këtu në shportë janë 100 kokrra. I kam rregulluar me tallash që të mos thyhet asnjë. Veç, po deshe mbaje shportën në prehër, se maqina tundet. Dhe i thuaj vëllait se e rregullova raportin e gruas. Pra do të vij pasnesër me gruan dhe fëmijët.

— Meqë vjen pasnesër, pse nuk i çon vetë?.. Mua më jep dhjetë kokrra. I mjaftojnë për dy ditë . . .

Përsëri foli gruaja:

— Merria, o dembel. Ne në plazh po vemë. Ik, Kolec, tani, se mbaroi kjo punë. Vezët sonte i ka vëllai në kabinë.

Njëqind falenderime Koleci, njëqind «s'ka përse» unë, dhe shporta zuri hëpërhë sedilen time në autobus.

Cigarja po merrte fund, kur . . .

— Shoku Latif, për ku po niseni kështu? — më pyeti Vangjelia, me të cilën dikur kemi bërë zborin.

— Unë . . . jo, jo . . . nuk shkoj kund . . . —

iu përgjegja shpejt e shpejt, se i pashë në dorë një fshesë dhe një pako të gjatë.

— Si, ore, nuk shkon kund? Në plazhin e Durresit po nisemi për pushime. Vangjeli, mos ke gjë për të çuar?

Gruaja ime e dashur nuk i pranon gënjeshttrat. Vangjelia u bë shend e verë.

— Të keqen motra ty, moj Bukurie, se burrat i kemi një çikë dembelë. Kam kushëririn, moj, oficer te Shkëmbi i Kavajës dhe u dogj për krap Shkodre. Ç'hoqi i ziu burrë gjersa ia gjeti, në drejtori të peshkimit vajti kërkoi, e çfarë krapit. 10 kile e 250 gram peshon pa letër. Krap për kokën e krapit.

— Te Shkëmbi i Kavajës? Sikur është larg... pastaj krapit... — desha të kundërshtoja unë qyqari, po Vangjelia nuk më la të mbaroja:

— E, mo, dhe ti, ne kemi bërë marshim 30 kilometra bashkë, apo e harrove zborin?... Sa për krapin, mos u bëj merak. E kam mbështjellë me letër celofani dhe nuk i vjen erë. Veç të lutem mbaje me kujdes që të mos shtypet rrugës, se, po u shtyp, i vate shija pastaj.

Iku Vangjelia duke marrë njëqind sigurime nga gruaja se sonte krapit do të tiganisej te Shkëmbi i Kavajës. Iku ajo, po erdhi Maksuti me një biçikletë të re «Mifa». M'u lut ta çoja në Shijak, sepse ia kishte porositur baxhanaku. Më dha dhe një letër shoqëruese:

— Në letër ka 35 lekë të rinj, është kusuri. Ruaje letrën, xhani i vëllait, unë të njoh, po ai mund të mendojë keq për ty pastaj. I thuaj gjithashtu se, po deshi zinxhirë rezervë, bëjnë nga 25 lekë copa, pra ndali aq lekë dhe jepi lekë kusur. Pyete mirë ama...

— More Maksut... ç'ma jep mua atë ngarkesë me telashe! Unë po shkoj në plazh për pushime, o lumëmadh? — iu qava unë. Ime shoqe, këtë radhë, nuk ndërhyri fare. E pa se u rëndova shumë. Po Maksuti qeshi:

— Telashe thua? Aspak, xhani i vëllait. Për shoferin ke hallin? Një fërnëta ta qerasësh dhe të hip shtëpinë në autobus. Veç, të lutem çoja sonte, se ndoshta i duhet nesër. Po deshe, ndalu dhe pi një kafe, se e bëjnë të mirë.

— Mirë, po ia hipi bicikletës dhe po e çoj gjer në Shijak — thashë me zemërim. Ai u habit.

— Bicikletës? E kam çmontuar, xhani i vëllait, se me gjithë qejf. Pastaj, dhe të mos ishte e çmontuar, si të bën zemra të mos ia dorëzosh mallin të ri që ta bëjë sefte...

Nxora bllokun të mbaja shënim: Tenxheren me presion në Durrës, pasi ta kisha pyetur Llambin në pasticerinë pranë Komitetit të Partisë. Një në dorë. 100 kokrra vezë te vëllai i Kolecit në plazh, kabina Nr.432. Dy në dorë. Krapin dhe fshesën nga eksporti te kushëriri i Vangjelisë, oficer te Shkëmbi i Kavajës. Tre në dorë. Bicikletën e re «Mifa» në Shijak, te baxhanaku i Maksutit. Katër në dorë. Dy shalqinj nga pesë kile copa që na i kishte sjellë Sokoli që mbrëmë në shtëpi për t'ia çuar nipit të gruas në Shkozë. Pesë në dorë. I bëra hesap me mend dhe më doli se këto porosi, përveç volumit që zinin, peshonin as më pak, as më shumë, po 40 kilogram, dhe duhej të bëja mbi 20 kilometra rrugë automobilistike suplementare për ta çuar secilën porosi në vend. Tek po mendoja kështu, më vjen Paloka, aktori i estradës, me vëllanë 10 vjeçar për dore. Duke buzëqeshur me ëmbëlsi, më tha:

— Desha të çoja vëllanë te kunata në Fier, që të kalojë disa ditë pushimi, po nuk po gjej njeri.

— Më vjen keq, — i thashë — do ta kisha marrë me gjithë qejf, po unë shkoj në plazhin e Durrësit për pushime me gjithë familje.


— Në Durrës? — bërtiti ai.

— Në Durrës — u përgjegja unë me njerëzi.

— Atëhere po ta lë ty që ta çosh gjer në Fier.

— Shkoj në Durrës — bërtita unë.

— E di, po mos u ndal aty, shko gjer në Fier.




Ja ku është Fieri nga Durrësi, bëje për mua këtë. Po të më vijë rasti, ta shpërblej. Së paku bileta est-trade të gjej.

Futi djalin në autobus, u përshëndet me gruan dhe nënën dhe, kur u ul, më dha disa porosi:

— Është i butë si qengj. Veç se e zë ca maqina. Prandaj, kur të vjellë, nxirrja kokën nga dritarja dhe, sa herë që të ndalet autobusi, mos i bli asgjë për të ngrënë përveç çokollatës dhe aranxhatës. Udhë të mbarë, shpirti i Palokës! E kaloshi mirë pushimin! Unë i mjeri gjer në gjysmë të gushtit jam në turne. Ja, pasnesër nisem në Fier. Prandaj po e nis djalin dy ditë para, që të mos e kem bela rrugës.

Ma la në dorë për nder. Ma la dhe iku. Dhe më falni se nuk po vazhdoj më gjatë. Sa herë që e kujtoj më zënë të dredhurat.



QIQRA TË JASHTME

Vrisja mendjen dhe shtrydhja muzën për të gjetur një subjekt tregimi për gazetën lokale, por frymëzimi nuk më vinte dot, megjithëse, duke ndjekur këshillën e një miku, rrufita pesë kafe njëra pas tjetrës dhe boshatisa një paqetë cigaresh «Partizani». Filloi të më rëndonte koka, më rrihnin tëmthat. Kur ja, trokiti dera. Thashë se mos ishte shpërndarësi i gazetave, i cili i sjell gazetatat si t'i teket, herë në mëngjez, herë në drekë e herë në darkë. Por nuk ishte ai. Qe Zadja, një fqinja jonë.

— Më fal se të shqetësova! Mos është Zana në shtëpi?

— Jo, është në punë. Ka turnin e dytë. Po ju urdhëroni! — i thashë.

— Mos e di ti se ku i lë qiqrat?

— Qiqrat?

— Ede, qiqrat!

— Ku ta di unë? Në dollap ndoshta, aty ku mbajmë ushqimet. Ç'ju duhen?

— Desha të pregatisja ca kafe. Thashë mos më jepte një grusht qiqra, po, meqë nuk është Zana, po vij më vonë.

— Pse të vish më vonë për një grusht qiqra? Po t'i jap unë! — i thashë.

Ajo u gëzua shumë, më falënderoi dhe më tha se isha burrë i mirë.

U futëm brenda dhe së bashku kërkuam nëpër dollap. Pas disa gjurmimesh Zadja e gjeti qeskën e qiqrave. Ishte një qeskë nailoni. Aty i kishte futur qiqrat Zana. Zadja e mori qeskën dhe e soditi me admirim.

— Sa qeskë e bukur! Që nga qeska shihet se ç'qiqra ka brenda — tha dhe mori e kënaqur një grusht qiqra.

Unë nuk e kuptova se ç'deshi të thoshtë. E përcolla dhe u ktheva te tryeza e punës. I bëra përsëri thirrje muzës, por, në vend që të vinte ajo, erdhi Aspasia, gruaja më e tmerrshme e lagjes sonë, që i di në majë të gishtërinjve pjesëtarët e familjes dhe lugët e çdo apartamenti, madje edhe markat e radiove. Nuk priti të shkëmbenim përsëritjet e rastit, por hyri menjëherë në temë:

— Ore, më jep edhe mua ca qiqra nga ato që i dhe Zades. Apo do të m'i kursesh mua?

— Pse t'i kursej, shoqja Aspasi! Përkundrazi, ty të jap më parë se askujt.

— Lëri ato, e di unë se si m'i jep... Hajde, luaj! I dua si të Zades!

— Natyrisht, nga ato do të t'i jap. Kemi një qeskë plot. Të tjera nuk kemi.

— Të tjerat nuk i dua as unë. Nga ato i dua!

Shkuam bashkë te dollapi dhe i lëshova në dorë qeskën prej nailoni. E soditi, tundi kokën me ironi dhe foli:

— Pse të mos jetosh ti, o lumëmadh! Lavatricën e bleve, televizorin po, gjithë të mirat i ke dhe qiqrat i ke të jashtme.

Unë u shtanga nga habia. Qiqra të jashtme! Nga na dolën këto? Mora një grusht në dorë. Ishin të zakonshme, kokërrmëdha, me ngjyrë të trëndafiltë.

— Po ç'të jashtme, moj Aspasi? Të tilla ka dyqani i lagjes plot.

— Kujt ia shet ato ti? — u shkreh Aspasia. — Nuk i ha unë ato. Edhe me sy mbyllur i njoh qiqrat e vendit.

Mori nga qeska gjysmën e qiqrave dhe doli.

Një krimb më brejti dhe mua. Mirë Aspasia, por Zadja pse e lavdëroi qeskën? Vërtet të ishin të jashtme qiqrat? Ku t'i kishte marrë gruaja? Ajo nuk më fshihte asgjë. Kur ra përsëri dera.

«Me siguri për qiqra,» thashë dhe e çela. Ishte Vitoria që banon në një kat me ne. Nuk është në punë, i pëlqen moda dhe bisedën e zbukuron me ca fjalë italiane.

Si je? — më tha dhe luajti dorën me gjest theatral.

— Mos doni dhe ju qiqra? — e pyeta.

— Intelixhent... Intelixhentisimo... Ma kapët në ajër mendimin.

Shkova mora çelësin dhe ia dhashë të gjitha qiqrat që kishin mbetur.

— Gracie!

— Nuk ka gjë aspak. Veç lajmëroni fqinjët e tjerë që të mos më bezdisin më për qiqra, se u mbaruan. Sa kisha, jua dhashë.

Gjithë inatin tani e kisha me Zanën. Kushedi ç'kishte përrallisur për qiqrat. Veç të kthehej, pa do ta bëja për dy para. Për një çast më breu dhe mua dyshimi. Mos vallë qiqrat ishin vërtet të jashtme? «Pa të pyes një herë shitësin e lagjes», thashë, dhe pasi u veshja, dola. Pa hyrë mirë në dyqan, shitësi ma priti:

— Ore Qamuran, më sill edhe mua ca nga ato qiqrat e jashtme që keni.

U bëra spec. Edhe shitësi kërkonte qiqra të jashtme.

— Ç'qiqra, or burazer, pse tallesh? Unë për këtë erdha, të pyes mos i ka blerë te ti gruaja ime? Shitësi qeshi me mosbesim.

— Qiqra vërtet ka blerë tek unë para një muaji, por e gjithë lagja flet për disa qiqra që paskeni ju, kokrra sa një arrë, qeska me fije argjendi, aro-ma e tyre të kënaqka shpirtin, ndërsa, kur i skuqke dhe i përzieke me kafe, shijen e kafesë e ndjen në gojë për një javë rrjesht. Do të më sjellësh edhe mua ca, apo jo?

«Hej, sherr! Ky e paska me gjithë mend. Ah, moj Zanë, ç'të polli mendja që na solle kaq telashe me qiqrat». Nuk ia zgjata shitësit, as ca grave që do të vinin për vizitë të pinin një kafe për merak.

Zana erdhi afër mesit të natës.

Midis nesh u zhvillua ky dialog:

— Mirë mbrëma! Nuk paske fjetur?

— Jo, të prisja ty. Do një kafe me qiqër?
— Kafe? Unë dua të ha, se vdiqa urie, ti më
thua kafe! Ç'kemi për darkë?

— Qiqra të jashtme.
— Qenke me nerva.
— Jo, jam me qiqra.
— Qiqra... Fjalë e qiqra... ç'dreqin ke?
— m'u shkreh më së fundi. Unë atë prisja, që të bë-
hej nerveze.

— Ku i ke blerë qiqrat? — e pyeta.
— Cilat qiqra?
— Ato të qeskës prej nailoni.
— Në dyqan, ku tjetër!
— Mos gënje!
— Ore, je në vete ti apo jo? Pse më fyen?
— Gjithë mëhalla më shqetësoi sonte. Vinin e
kërkoni qiqra të jashtme. Bile dhe vetë shitësi m'i
kërkoi.

Zana në fillim rrudhi vetullat, pastaj u çel në
fytyrë dhe ia plasi një të qeshure me lot. Qeshte
dhe mbante barkun me dorë. Kur u qetësua, më tre-
goi:

— Para një muaji bleva një kilogram qiqra.
Rrugës m'u ça qeska. Në shtëpi kërkova një qeskë
tjetër. Nuk gjeta. Atëhere mora qeskën prej nailoni
të çorapeve, që më solle dhuratë për 8 Marsin dhe
i futa qiqrat brenda. Dje erdhi Violeta, mamia, për
vizitë. Unë i bëra një kafe. Ti e di se, kur përzihet
kafeja me qiqër, bën më tepër shkumë dhe ka një
shije të veçantë. Violeta e piu kafënë dhe tha:

— «Sa të mirë e bëke kafënë»!
— Kam një sekret — u talla.
— Ma trego edhe mua!

— Me gjithë qejf, — i thashë — veç të mbetet në mes nesh.

Ajo u betua dhe unë i tregova qeskën me qiçra.

— Sa qeskë e bukur! — tha ajo. — Ç'ka brenda?

— Qiçra.


— Të jashtme? — pyeti ajo.

— «Natyrisht» — i thashë. Unë u talla, sepse isha e bindur se edhe ajo tallej. Por ja se ç'paska ngjarë... I shkreti ti ç'paske hequr!

Legjenda e qiçrave të jashtme vazhdoi për disa kohë. Gruaja shkoi përsëri te shitësi dhe bleu qiçra. Mori edhe qeskën prej nailoni me vete me qëllim që, kur të kthehej në shtëpi, ta shikonin gratë e lagjes. Shitësin e luti të mos i thoshte askujt.

Ai qeshi dhe pranoi. Kështu gratë erdhën përsëri të lypnin qiçra të jashtme, po Zana tani ua jepte me kokrra si farmacisti aspirinat. Vetëm Aspasisë i jepte me grusht. Do të kishte vazhduar gjatë kjo mesele, por shitësi u mërzit dhe e nxori sekretin.

Kur mësuan të vërtetën, disa gra u turpëruan, disa të tjera qeshën për budallallëkun.



ALUSH EFENDIU

Alush efendiu kishte emër të mirë në qytetin tonë të Veriut. Falte pesë vaktet e namazit në xhaminë me dy minare, shikonte punën e tij dhe me politikë nuk merrej. Për këtë mendim të pjekur shumë esnafë të qytetit e merrnin si shembull. Madje kishte të tillë që mundoheshin edhe ta imitonin Alushin në çdo gjë, në ecje, në buzëqeshje, deri në përkuljet gjithë nur të gjunjëve kur falej.

Shtëpinë e kishte në një rrugicë të thellë, rrethuar me mure të larta që sytë lakmitarë të kalimtarëve të mos arrinin deri te hanëmi i tij. Dyqanin e kishte në pazar, prandaj një landon e merrte dhe e sillte çdo ditë nga shtëpia në dyqan dhe anasjelltas. Vetëm ditën e premte karroca nuk vinte. Atë ditë Alushi nuk dilte në pazar. Pasi falte sabahun në shtëpi dhe pinte kafënë «sade» që ia sillte ha-

nëmi në një tabaka të argjendë, thërriste shërbëtorin dhe e pyeste:

— Sa u bënë, o Sadik?

— Nja shtatë a tetë, efendi — përgjegjej Sadiku me përlulje të thellë.

— Kur të shtohen edhe dy herë aq, më bëj zë — vazhdonte efendi dhe dridhte me nge një cigare duhan kaush.

Kalonte dhe një gjysmë ore dhe Sadiku vinte ta lajmëronte se ishin bërë. Atëhere Alushi vinte në kokë fesin e zi prej kadifeje, spërkaste me parfum tufën e mëndafshhtë të tespiheve dhe dilte rëndë-rëndë te porta e shtëpisë. Pas tij vinte Sadiku me një grusht qindarkash. Te porta e përshëndetnin në kor një duzinë pleqsh lypës.

— Të ngjattë zoti ymrin, Alush efendi.

— Më këputet shpirti për ju, o të mjerë — ishte përgjegjja e zakonshme e efendiut që i bënte me shenjë Sadikut. Ky i fundit u shpërndante lypësve nga një qindarkë. Secili që merrte qindarkën vinte i puthte dorën Alushit. Kjo i jepte kënaqësi të veçantë, sepse kalimtarët ndaleshin e shikonin këtë «bamirës» që po e «shkrinte» pasurinë për fukarenjtë.

Ky ishte akti i parë i ditës së premtë, aktet e tjera i kalonte në kafenenë e reshperëve, përballë prefekturës, ose, asëll asëll përballë burgut, sepse prefektura dhe burgu në qytetin tonë ishin ngjitur. Në këtë kafene përveç tregëtarëve të nderuar, nganjëherë vinte edhe prefekti, ndërsa drejtori i burgut dhe komandanti i xhandarmerisë vinin më shpesh. I zoti i kafenesë, jo vetëm që piqte kafe, por edhe të qethte e të rruante, të hiqte dhëmbët e prishur e për të bërë synet fëmijët, «kishte dorën më të lehtë

në gjithë qytetin». Në këtë kafene, përveç Aliut, të gjithë merreshin me politikë. Aliu nuk e hante atë kokërr ulliri. Shikonte punën e tij. Dhe askush nuk e trazonte.

Mirëpo na erdhi një ditë që Aliu pa dashje u fut këmbë e kokë në politikë, pikërisht një javë pasi bleu nga bashkia e qytetit të drejtën e bazhdarisë (mbledhjes së taksave në treg). E bleu bazhdarinë, sepse ai që e kishte pasur një vit përpara kishte mbledhur para me grusht. Pse të mos i mblidhte edhe Alushi? Kështu e bleu për 500 napolona, me shpresë që të mblidhte 5000. Ditët e para puna i shkoi mirë. Dyqanxhinjtë i paguanin në rregull taksat, vetëm me shitësit ambulantë dhe fshatarët i polli sherri. Ata, posa i shihnin tagrambledhësit, zhdukeshin nëpër rrugica. Policët vraponin pas tyre. Disa i zinin dhe ua sekuestronin mallin që shkonte në favor të Alush efendiut. Ndonjë që kundërshtonte e futnin në burg, madje e rrihnin. Kështu, emri i mirë i efendiut po merrte dheun.

Atë ditë të premtë, Alushi nuk do ta harronte kurrë.

Thirri Sadikun që ta pyeste sa lypës ishin pas portës dhe u çudit kur mori vesh se nuk ishte asnjë. Nuk besoi dhe doli vetë te porta. Jo vetëm nuk pa lypës, por ajo që ishte më e keqe, dikush kishte shkruar me bojë të kuqe në derë këto fjalë: «Ti që u pi gjakun të varfërve, nuk na gënjen dot me qindarka».

Sa nuk i ra pika Alushit nga kjo hata. Urdhëroi me të shpejtë Sadikun që t'i fshinte ato fjalë të kobshme, por ai matuf u ra me bojë të bardhë gërmave të kuqe e tani fjalët dukeshin më mirë në sfondin e zi të portës. Aliu u tërbua më tepër dhe lë-

shoi një fjalë të ndyrë, duke e prishur abdesin që kishte marrë.

Lyeje krejt portën me të bardhë, hajvan! — urdhëroi shërbyesin dhe doli. Shkoi në kafënë, ku për fat gjeti edhe prefektin, edhe komandantin e xhandarmërisë, edhe Sadikun, avokatin më në zë të qytetit. Ata e përshëndetën ftohtë, sepse po bisedonin me zë të ulët. Alushi u afrua te tryeza e tyre dhe me një frymë u tregoi për shkrimin e tmerrshëm. Prefekti e pyeti:

— Me bojë të kuqe?

— Si urdhëron! Dukej si e shkruar me gjak.

— Edhe në portën time kështu kanë shkruar.

— Janë komunistët — shtoi komandanti. —

Ata përdornin bojën e kuqe.

Këto fjalë dhe të tjera që u thanë atë ditë për komunistët e tmerruan Alushin dhe sidomos fjalët e prefektit se komunizmi ishte sëmundje e keqe që ngjitej shpejt.

— Ne do të marrim masa, Alush efendi, por edhe ti shiko se mos nuhat ndonjë komunist në treg dhe na lajmëro. Dimë ne si e rregullojmë me të pastaj.

Alushi premtoi, dhe u «fut» në politikë. Që atë ditë vrapoi në treg dhe pas një ore kishte përpara në zyrën e bazhdarisë një «komunist». Ishte një shitës akulloreje pa lejë zanati.

— More zotni, — qahej shitësi kur hyri në zyrë Alushi — unë kam bërë lutje në bashki për të shitur akullore në lulishten popullore, por nuk më janë përgjegjur ende.

— I huaj është ky? — pyeti Alushi nëpunësin e bazhdarisë.

— Jo, është nga qyteti ynë:

— Pse nuk flet shqip, more djalë? — pyeti Alushi.

— Shqip po flas — u përgjegj shitësi.

— Pa thuaj edhe një herë çfarë the qëparë?

Shitësi përsëriti çështjen e lutjes.

— Asgjë nuk merr vesh — u inatos efendiu.

Ndërhyri nëpunësi:

— Efendi, ai thotë se i ka bërë rixha beledijes për të shitë dollidullmah në miletbahçe, por xhevap nuk ka marrë hala.

— Ashtu thuaj, kjo është shqip — tha efendiu dhe kërkoi të shihte akulloren në enën cilindrike të shitësit. U tmerrua, kur pa një masë të kuqe si gjak që lëshonte avuj të ftohtë.

— Arrestojeni shpejt këtë ujk! Është komunist — bërtiti me të madhe. Xhandari, që atë mëngjes kishte marrë urdhëra të rrepta nga komandanti për të arrestuar në vend komunistët, i vuri prangat shitësit të habitur dhe e mori përpara me shqelma. Ena e akullores mbeti në zyrë. Alushi e shikonte si një qen të tërbuar që është bërë gati të kafshojë.

— Kujdes, — i tha nëpunësit — është helm i tmerrshëm. Sot lypësit kanë ngrënë këtë helm, prandaj asnjëri nuk erdhi në portën time. Or Sadik! Kush e ha këtë, bëhet menjëherë komunist. Këtë e kanë sjellë nga Rusia.

Nëpunësi qeshi nën buzë dhe nuk bëri zë.

Pas gjysmë ore ia behu komandanti i xhandar-mërisë. Dy policë e nxorën enën e akullores para ndërtesës së bazhdarisë ku u mbledh një numër njerëzish. Komandanti hapi kapakun e enës dhe ftoi njerëzit që të shikonin se çfarë helmi përdorte komunisti.

— Shikojeni ngjyrën e kuqe! Kush ha nga kjo akulllore, bëhet komunist.

Populli grumbullohej edhe më afër. Dikush qeshte, dikush tallej, ndonjë besonte vërtet. Komandanti përdridhte mustaqet. I dukej se ekspozimi po bënte efekt. Por ja, doli një hamall e tha:

— Unë qëparë hëngra një akulllore të tillë, po m'u duk e mirë.

— Arrestojeni! — urdhëroi komandanti. Xhandarët iu hodhën hamallit dhe e lidhën. Atë çast në zyrë ra zilja e telefonit dhe nëpunësi iu afrua oficerit.

— Ju kërkon prefekti në telefon.

Prefekti kishte marrë vesh rrëmujën në treg dhe...

— More hajvan, — i çirrej komandantit — teatër po jep në treg! Po bëheni gazi i qytetit ti me atë gomarin Alush. Derdhni akulloren ose hajeni vetë, se nuk ju bën gjë. Komunizmin mos e kërkon në akulllore, por në zemrat e njerëzve, në pakënaqësitë që shfaqin për lartmadhërinë e tij. Lirojeni shitësin, se nuk është komunist.

— Po hamallin? — pyeti komandanti.

— Gomar! — qe përgjegjja e prefektit që mbylli telefonin.

— Hë, çfarë të tha prefekti? — e pyeti Alushi. Komandanti i kuq në fytyrë iu shkreh efendiut:

— Prefekti më tha se ti, hanëmi yt dhe gjithë soji yt jeni gomarë.

Alush efendiu kishte mbetur me gojë hapët. Komandanti i ra me shqelm enës me akulllore të shkri-rë që u derdh në kalldrëm, ndërsa turma qeshte me të madhe.

PASQYRA E LËNDËS

| | Faqe |
|------------------------------------|------|
| Fajin e kishte «Besa» | 3 |
| Tregim për shoqen Zylfije | 8 |
| Jam shumë i kënaqur | 12 |
| Të mbetet midis nesh | 17 |
| I gëzofsh këpucët e reja | 21 |
| Pse kakarisin pulat | 25 |
| E gjeta atë që ndez | 30 |
| Nuk do ta përsërit kurrë më | 33 |
| Gjeniu i shkollës rrezikohet | 38 |
| «Të famshmit» e lagjes sonë | 44 |
| Atë ditë që u nisa në plazh | 53 |
| Qiqra të jashtme | 59 |
| Alush efendiu | 66 |